

# SHOQATA KOMBËTARE E GJYQTARËVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

---

Tiranë, më 19.04.2022

## K Ë R K E S Ë

**Kërkues:** Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë (SH.K.GJ.R.SH), regjistruar si person juridik në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin Nr. 2160, datë 25.01.2008.

**Drejtuar:** Këshillit të Lartë Gjyqësor, Adresa: Bulevardi Zogu I, Tiranë, 1000.

**Objekti:** Ndryshimi dhe plotësimi i Udhëzimit Nr. 38, datë 28.02.2019 “PËR PAGESAT E GJYQTARËVE NË DITËT E PUSHIMIT JAVOR DHE FESTAVE ZYRTARE” i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**Baza ligjore:** Nenet, 4, 7, 116, 118, 138 dhe 145 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 1, 11 dhe 22 i Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

*E nderuar Kryetare!*

*Të nderuar anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor!*

Po ju paraqesim më poshtë kërkesën tonë duke parashtruar faktet dhe rrethanat, ligjin përkatës, ku jemi mbështetur, analizën dhe arsyetimin ligjor, për të arritur në konkluzionin se kërkesa tonë duhet pranuar.

### **I. Faktet e çështjet.**

1. Me Udhëzimin Nr. 38, datë 28.02.2019 “PËR PAGESAT E GJYQTARËVE NË DITËT E PUSHIMIT JAVOR DHE FESTAVE ZYRTARE” Këshilli i Lartë Gjyqësor, ka vendosur: “1. Gjyqtari që ushtron funksionin në ditët e pushimit javor apo festave zyrtare, përfiton shtesë page në masën 50% të pagës së tij ditore. 2. Gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë dhe/ose gjyqtari i gjykatës së apelit kompensohet financiarisht sipas pikës 1, vetëm nëse gjykon çështje urgjente, për të cilat dispozitat procedurale parashikojnë se duhet të vendoset brenda 24-72 orëve nga regjistrimi i çështjes në gjykatë. 3. Në çdo rast gjykata duhet të ketë fonde të miratuara për këtë qëllim në buxhetin vjetor të saj. 4. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij udhëzimi, fillojnë në datën 1 janar 2019. Ky udhëzim hyn në

*fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*”. Nga përmbajtja e këtij udhëzimi rezulton se gjyqtari në ditët e pushimit javor apo festave zyrtare, duke përfshirë edhe ditën kur ai është i gatshëm përfiton shtesë page në masën 50% të pagës së tij ditore vetëm nëse gjykon çështje urgjente, për të cilat dispozitat procedurale parashikojnë se duhet të vendoset brenda 24-72 orëve nga regjistrimi i çështjes në gjykatë. Pra, edhe pse gjyqtari sipas listës së gadishmërisë është i gatshëm, për rrjedhojë në detyrë ditët e pushimit javor dhe të festave zyrtare, ku mund të ushtrojë veprimtari procedurale si studimi i dosjes gjyqësore dhe përgatitja e çështjeve urgjente për gjykim nuk mund të paguhet nëse nuk merr vendim në këto ditë. Gjithashtu, gjyqtarët nuk paguhen gjatë ditëve të gadishmërisë që korrespondojnë me ditët e pushimit javor edhe pse ata prezumohen në detyrë e për rrjedhojë kanë kufizime për të bërë planifikimin e fundjavës për të dalë jashtë shtetit apo për të kryer aktivitete të tjera, pasi duhet të jenë në gadishmëri për të shqyrtuar çështjet urgjente. Para këtij udhëzimi gjyqtarët janë paguar në ditët e gadishmërisë që korrespondojnë me ditët e pushimit javor apo festat zyrtare edhe nëse nuk kanë marrë vendime në këto ditë. Kjo do të thotë se nëpërmjet këtij udhëzimi janë ulur përfitimet që gjyqtarët kanë përfituar për shkak të detyrës.

2. Me shkresën Nr. 636 Prot., datë 30.04.2019 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, i është kërkuar Këshillit të Lartë Gjyqësor intepretimi i udhëzimit Nr. 38, datë 28.02.2019 “PËR PAGESAT E GJYQTARËVE NË DITËT E PUSHIMIT JAVOR DHE FESTAVE ZYRTARE”. Kështu, nëpërmjet kësaj shkrese kërkohet të sqarohet nëse kompesimi i gjyqtarëve do të bëhet fillimisht me ditë pushimi para se të bëhet kompesimi financiar si dhe nëse gjyqtarët do të paguhen për gjithë ditën e punës apo vetëm për orët që gjyqtari ka qëndruar në punë?

2.2. Në shkresën Nr. 2491/1 Prot., datë 28.05.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, me lëndë: “*Kthim përgjigje*” ndër të tjera arsyetohet se: “*Lidhur me kërkesën për interpretim përsa i përket mënyrës së zbatimit të vendimit nr. 38, datë 28.02.2019 “Për pagesat e gjyqtarëve në ditët e pushimit javor dhe festave zyrtare”, ju sqarojmë se:*

- *Gjyqtari i shkallës së parë ashtu dhe ai i apelit do të kompesohet financiarisht, vetëm nëse i duhet të gjykojë në ditët e pushimit javor apo festave zyrtare çështje urgjente, për të cilat dispozitat procedurale parashikojnë se duhet të vendoset brenda 24-72 orëve nga regjistrimi i çështjes në gjykatë;*
- *Gjyqtarëve të cilët janë në gadishmëri sipas grafikut të gadishmërisë e listës që parashikon neni 37/d ligji nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, nuk iu paguhen ditët e pushimeve javore, vetëm për shkak të qenies në listë. Ato paguhen vetëm nëse do të gjykojnë çështje urgjente nga ato të përcaktuara në udhëzim;*
- *Gjyqtarët të cilët nuk janë të gatshëm por dalin në punë, zhvillojnë seanca e japin vendime në ditët e pushimeve javore dhe festave zyrtare, në kuadër të shqyrtimit të kërkesave “zinxhir” të fazës së hetimit paraprak për procedimet penale të regjistruara gjatë kohës që to kanë qenë të gatshëm e që vijojnë sipas nenit 278/2 i Kodit të Procedurës Penale, do të paguhen. **Kompensimi i tyre me pushim do të ishte ndërhyrje në planifikimin e ushtrimit të veprimtarisë gjyqësore, për të cilën***

*gjqytari gëzon pavarësi. Sqarohet se në rastin konkret, neni 96 i K.Punës zbatohet në përputhje me natyrën e ushtrimit të funksionit nga ana e gjyqtarit.*

- *Lidhur me mënyrën e pagesës, për të gjithë ditën apo për kohën që qëndrojnë në punë, theksojmë se çdo nëpunës shtetëror përfshi këtu edhe gjyqtarët, që marrin paguhet nga buxheti i shtetit, e marrin atë përkundrejt kohës së kryerjes së tij. Parimisht për gjyqtarët që gjykojnë në ditët e festave zyrtare apo pushimi javor është pranuar kompensimi i plotë për gjithë kohëzgjatjen e ditës së punës, sepse gjyqtari veç zhvillimit të seancave, duhet të studiojë aktet e dosjes, arsyetohet vendimin apo edhe të kryejë veprime të tjera procedurale që lidhet me çështjen e gjykuar prej tij. Në pamundësi për të matur kohën efektive, në udhëzim është parashikuar kompensimi i plotë.”*

2.3. Megjithëse në shkresën Nr. 2491/1 Prot., datë 28.05.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor është theksuar se për shkak të natyrës së punës gjyqtarët duhet të paguhet për gjithë ditën e punës (kompensimi i plotë), nga informacionet e marra nga gjyqtarë që ushtrojnë detyrën në gjykata të ndryshme bëhet me dije se zbatohen standard të ndryshme. Në pjesëm më të madhe të gjykatave zbatohet kompensimi i plotë, ndërsa në gjykatën e Tiranës dhe Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin të Organizuar gjyqtarët paguhet me orë si pjesa tjetër e administratës. Ndodhur në këto kushte, për zbatimin uniformë të rregullave të kompensimit të plotë, duhet të plotësohet udhëzimi nga Këshilli i Lartë Gjyqësor duke sanksionuar parimi i kompensimit të plotës sikurse e pasqyruar me të drejtë në shkresën Nr. 2491/1 Prot., datë 28.05.2019.

3. Në nenin 3 të Statutit të SHKGJRSH-së, nën titullin “**Qëllimi dhe veprimtaria**”, ndër të tjera përcaktohet shprehimisht se: “*Shoqata ka këto qëllime dhe kryen këto veprimtari: ... zhvillimin dhe implementimin e statusit të gjyqtarëve në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe me standardet ndërkombëtare në këtë fushë; synon mbrojtjen dhe garantimin e statusit të gjyqtarëve, si dhe ruajtjen e pavarësisë dhe garancive të tjera të pushtetit gjyqësor.*”. Ndërkohë në nenin 147 pika 1 të Kushtetutës parashikohet se: “*1. Këshilli i Lartë Gjyqësor siguron pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë.*”. Pra, si SHKGJRSH-së dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor kanë të njëjtin mision garantimin e statusit të gjyqtarëve, si dhe ruajtjen e pavarësisë dhe garancive të tjera të pushtetit gjyqësor, ku një nga komponentët e rëndësishëm të pavarësisë së gjyqësorit është dhe pavarësia financiare.

4. Sa më sipër, në funksion të garantimit të pavarësisë financiare të gjyqtarëve SHKGJRSH do të paraqesë argumentet kushtetuese dhe ligjore në funksion të ndryshimit dhe plotësimit të Udhëzimit Nr. 38, datë 28.02.2019 “PËR PAGESAT E GJYQTARËVE NË DITËT E PUSHIMIT JAVOR DHE FESTAVE ZYRTARE” të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

## **II. Ligji i zbatueshëm.**

5. Dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në të cilat është parashikuar:

5.1. Preambula e Kushtetutës në të cilën aspirohet shteti i së drejtës: “*Ne, Populli i Shqipërisë, krenarë dhe të vetëdijshëm për historinë tonë, me përgjegjësi për të ardhmen, me besim te Zoti dhe/ose te vlera të tjera universale, me vendosmërinë për të ndërtuar një shtet të së drejtës, demokratik e social, për të garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut,*

me frymën e tolerancës dhe të bashkëjetesës fetare, me zotimin për mbrojtjen e dinjitetit dhe të personalitetit njerëzor, si dhe për prosperitetin e të gjithë kombit, për paqen, mirëqenien, kulturën dhe solidaritetin shoqëror, me aspiratën shekullore të popullit shqiptar për identitetin dhe bashkimin kombëtar, me bindjen e thellë se drejtësia, paqja, harmonia dhe bashkëpunimi ndërmjet kombeve janë ndër vlerat më të larta të njerëzimit.”.

**5.2.** Neni 4 i Kushtetutës: “1. E drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit. 2. Kushtetuta është ligji më i lartë në Republikën e Shqipërisë. 3. Dispozitat e Kushtetutës zbatohen drejtpërsëdrejti, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon ndryshe.”.

**5.3.** Neni 116 i Kushtetutës: “1. Aktet normative që kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë janë: a) Kushtetuta; b) marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara; c) ligjet; ç) aktet normative të Këshillit të Ministrave. 2. Aktet që nxirren nga organet e pushtetit vendor kanë fuqi vetëm brenda juridiksionit territorial që ushtrojnë këto organe. 3. Aktet normative të ministrave dhe të organeve drejtuese të institucioneve të tjera qendrore kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë brenda sferës së juridiksionit të tyre.”.

**5.4.** Neni 118 i Kushtetutës: “1. Aktet nënligjore nxirren në bazë dhe për zbatim të ligjeve nga organet e parashikuara në Kushtetutë. 2. Ligji duhet të autorizojë nxjerrjen e akteve nënligjore, të përcaktojë organin kompetent, çështjet që duhen rregulluar, si dhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto akte. 3. Organi i autorizuar me ligj për të nxjerrë akte nënligjore, siç specifikohet në paragrafin 2 të këtij neni, nuk mund t’ia delegojë kompetencën e tij një organi tjetër.”.

**5.5.** Neni 138 i Kushtetutës: “**Paga dhe përfitimet e tjera të gjyqtarit nuk mund të ulen**, përveç rasteve kur: a) nevojitet marrja e masave të përgjithshme ekonomiko-financiare për të shmangur situata të vështira financiare të vendit ose emergjenca të tjera kombëtare; b) gjyqtari kthehet në detyrën që mbante para emërimit; c) i jepet një masë disiplinore ose vlerësohet i pamjaftueshëm profesionalisht, sipas ligjit.”.

**5.6.** Neni 147 pika 1 i Kushtetutës: “1. **Këshilli i Lartë Gjyqësor siguron pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë.**”.

**6.** Dispozitat e Ligjit Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” në të cilat është parashikuar:

**6.1.** Neni 1 i Ligjit Nr. 96/2016 parashikon: “1. **Objekti i këtij ligji është përcaktimi i statusit të magjistratëve, duke parashikuar rregulla në lidhje me: a) të drejtat dhe detyrimet e tyre; b) pranimin dhe emërimin e tyre; c) zhvillimin e karrierës dhe mbarimin e mandatit të tyre; ç) vlerësimin etik dhe profesional të tyre; d) përgjegjësinë disiplinore, penale dhe civile të tyre; 2. Sipas parashikimeve të këtij ligji, statusi gëzohet ligjërisht nga një person që sapo emërohet në funksion dhe përfundon me mbarimin e statusit të magjistratit.**”.

**6.2.** Neni 2 gërma “gj” i Ligjit Nr. 96/2016 parashikon: “Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime: ....gj) “**Magjistrat**” është gjyqtari, me përjashtim të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, prokurori dhe kryetarët në kuptim të shkronjës “g” të këtij neni.”.

**6.3.** Neni 10 i Ligjit Nr. 96/2016 parashikon: “1. **Magjistratët kanë të drejtë të themelojnë shoqata ose organizata dhe të marrin pjesë në to, me qëllim: a) mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të tyre; b) ngritjen e tyre profesionale.** 2. Shoqatat ose organizatat e magjistratëve në ushtrimin e aktivitetit nuk duhet të bien ndesh me kompetencat e institucioneve të drejtësisë.”.

6.4. Neni 11 i Ligjit Nr. 96/2016 parashikon: “**1. Paga e magistratit dhe përfitimet e tjera financiare duhet të jenë në përputhje me dinjitetin e detyrës së magistratit dhe të përshatshme për të garantuar pavarësinë dhe mbrojtjen nga ndërhyrjet e jashtme në ushtrim të funksionit të tyre.** 2. Paga e magistratit caktohet në bazë të kriterëve të mëposhtme: a) shkalla e gjykatës ose prokurorisë ku magistrati ushtron funksionin; b) vjetërsia në ushtrimin e funksionit; c) fusha e veçantë e kompetencës lëndore në të cilën magistrati ushtron funksionin; ç) pozicioni drejtues. 3. Përfitimet e tjera financiare përfshijnë: a) kompensim për shërbimin në skemën e delegimit, për transferimin e përkohshëm ose për caktimin e përkohshëm; b) shpërblim për aftësi; c) pension shtetëror suplementar, sipas parashikimit të këtij ligji dhe legjislacionit për pensionet shtetërore suplementare; ç) çdo përfitim tjetër, duke u bazuar në kushtet e veçanta të punës ose gjendjen personale dhe atë familjare të magistratit, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.”.

6.6. Neni 22 i Ligjit Nr. 96/2016 parashikon: “**1. Paga dhe përfitimet e tjera të magistratit nuk mund të ulen**, me përjashtim të rasteve kur: a) ka situata të vështira financiare në vend ose emergjenca të tjera kombëtare, duke marrë parasysh faktorët si vijon: një mospërputhje e qartë midis dinamikës së pagave të magistratëve dhe dinamikës së pagave standarde në shërbimin civil; indeksi i pagesave, ashtu si dhe indeksi i çmimeve të konsumatorit. Këta faktorë është e nevojshme që të vlerësohen, për të gjetur balancën mes paprekshmërisë së pagës dhe nevojës për të shmangur marrjen e borxheve të reja; b) magistrati ushtron të drejtën për t’u kthyer nga një pozicion i mëparshëm më i lartë ose më i specializuar ose me mandat të kufizuar dhe me pagesë më të lartë; c) magistrati ka masë disiplinore; ç) vjen si pasojë e një vlerësimi të ulët etik dhe profesional, sipas parashikimeve të këtij ligji. 2. Magistrati duhet të kthejë shumat e përfituara të pagës ose përfitimeve financiare nëse ka përfituar më shumë sesa është parashikuar në ligj.”.

7. Dispozitat e Ligjit Nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” në të cilat është parashikuar:

7.1. Neni 2 gërma “c” i Ligjit Nr. 98/2016 parashikon: “Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime: ...c) “**Çështje urgjente**“ është çështja për të cilën dispozitat procedurale parashikojnë se duhet të vendoset brenda 14 ditëve nga regjistrimi i çështjes në gjykatë.”.

7.2. Neni 37 gërma “b” i Ligjit Nr. 98/2016 parashikon: “**Kryetari i gjykatës ka përgjegjësi për menaxhimin e përgjithshëm gjyqësor dhe ushtron këto detyra: ...b) në fillim të çdo viti miraton një listë, e cila përditësohet kur është e nevojshme, që përcakton gjyqtarët për gjykimet e rasteve urgjente, siç përcaktohet me ligj, sipas rendit alfabetik me bazë mbiemrin, në përputhje me rregullat e miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor;**

7.3. Neni 91 pika 4 i Ligjit Nr. 98/2016 parashikon: “**4. Të gjitha aktet nënligjore, të miratuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, zbatohen për aq sa nuk bien në kundërshtim me këtë ligj.**”.

8. Vendimi Nr. 238/1/a Datë 24.12.2008 “PËR PROCEDURAT E NDARJES ME SHORT TË ÇËSHTJEVE GJYQËSORE” i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i ndryshuar, i cili zbatohet në veprimtarinë e përditshme të gjykatave, pasi nuk ka humbur fuqin e tij ligjore. Kështu, në nenin 1 të këtij vendimi, nën titullin “**Ndarja e çështjeve me short**” parashikohet shprehimisht se: “**1. Shorti i çështjeve që paraqiten në gjykatat e shkallës së parë dhe në gjykatat e apelit, realizohet vetëm në rrugë elektronike. 2. Bëjnë përjashtim nga hedhja në**

*short, këto raste: a -kërkesat penale gjatë hetimeve paraprake, për gjykimin e të cilave bëhet planifikimi i gjyqtarëve nga kryetari i gjykatës sipas ligjit nr.9877 datë 18.02.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, neni 18, pika 3, gërma “c” b - kërkesat civile të natyrës urgjente si: lëshim i urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, sigurim i padisë, apo çdo kërkesë tjetër me karakter të ngutshëm procedural, si edhe për kërkesat penale të parashikuara nga gërma “a” e kësaj dispozite, të paraqitura gjatë periudhës së lejes vjetore. Këto kërkesa, mund të mos i nënshtrohen procedurave të shortit të mësipërm, por i kalojnë për shqyrtim gjyqtarit të planifikuar për periudhën e gatishmërisë nga kryetari i gjykatës.”*

### III. Vlerësimi ligjor.

#### 1. Garantimi i pavarësisë së gjyqësorit dhe respektimi i parimit të sigurisë juridike.

9. Statusi i gjyqtarit, si një nga elementët e pavarësisë së tij, përbëhet nga të drejtat dhe detyrimet (kufizimet) që ai mbart për shkak të ushtrimit të këtij funksioni kushtetues. Ndër të drejtat që gjyqtarët gëzojnë, si pasojë e pasjes së statusit të tyre, janë paga dhe përfitimet e tjera me natyrë financiare dhe jo financiare. Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” merr përsipër mënyrën e përlllogaritjes së pagës së gjyqtarëve si dhe disa prej përfitimeve të tjera financiare, duke qenë një ndër elementët më themelorë të statusit të këtyre funksionarëve kushtetues. Ndërkohë, me akte të tjera ligjore dhe nënligjore, përkatësisht ligjvënësi dhe pushtetit ekzekutiv, mund të akordojnë privilegjeve të tjera për këtë kategori funksionarësh (gjyqtarët) si pjesë e të drejtave që burojnë nga statusi. Në momentin që këto privilegjeve akordohen, ato bëhen pjesë e statusit të funksionarit në fjalë. Në një situatë të tillë privilegji, i dhënë me çdo lloj akti ligjor apo nënligjor, bëhet pjesë e statusit dhe nuk mund të cenohet më me akte të mëtejshme ligjore apo nënligjore. Të vetmet përjashtime për të cilat statusi mund të preket në aspektin përkeqësues janë parashikuar në nenin 138 të Kushtetutës si dhe në nenin 22 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, çka nuk provohet të ekzistojë në situatën konkrete.

10. Shtrirja e statusit të gjyqtarit edhe ndaj përfitimeve të tjera, krahas atyre me natyrë ngushtësisht financiare del jo vetëm nga përmbajtja e nenit 138 të Kushtetutës si dhe nenit 22 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, por është konfirmuar edhe nga jurisprudenca konstante e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë. Në disa vendime të saj kjo gjykatë është shprehur se me termin “përfitime të tjera”, duhen kuptuar jo vetëm ato me natyrë financiare por edhe të drejta të tjera, sikurse mund të jetë p.sh e drejta për karrierë e gjyqtarit, të cilat pasi u jepen u këtyre të fundit, nuk mund tu hiqen më, pasi mbrohen nga parimet kushtetuese të pavarësisë së pushtetit gjyqësor dhe të sigurisë juridike, të cilat në drejtim të gjyqtarit kanë krijuar koracën e statusit të tij.

11. Një nga parimet më të rëndësishme të sanksionuara në disa norma kushtetuese është edhe pavarësia e pushtetit gjyqësor. Pavarësia e gjyqtarëve dhe e gjykatave nuk është e sanksionuar si privilegj apo qëllim në vetvete, por ajo lidhet me mirëfunksionimin e shtetit dhe të drejtën e shtetasve për të pasur një sistem gjyqësor efektiv dhe funksional, me qëllim garantimin e një procesi të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42/2 të Kushtetutës (*shih*

*vendimet nr. 31, datë 02.12.2009 dhe nr. 11, datë 02.04.2008 të Gjykatës Kushtetuese).* Gjykata ka theksuar se statusi ligjor i gjyqtarëve duhet të jetë në funksion të garantimit të pavarësisë së pushtetit gjyqësor. Parimi i pavarësisë së gjyqësorit përfshin një gamë të gjerë aspektesh, të cilat të marra së bashku, krijojnë kushtet e nevojshme që gjykatat të përmbushin rolin dhe detyrat e tyre, veçanërisht në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Vlerësimi i sistemit të garancive dhe pavarësia e gjyqtarëve dhe gjykatave janë ngushtësisht të ndërlidhura ndërmjet tyre. Garancitë kushtetuese për statusin e gjyqtarit lidhen kryesisht me emërimin, paprekshmërinë dhe palëvizshmërinë e tyre nga detyra pa shkaqe të përligjura, me mosndjekjen e tyre penalisht pa pëlqimin e KLD-së dhe disiplinarisht pa vendim të motivuar të KLD-së, si dhe me garancitë financiare (*shih vendimet nr. 5, datë 16.02.2012; nr. 26, datë 24.07.2009; nr. 11, datë 02.04.2008 dhe nr. 11, datë 27.05.2004 të Gjykatës Kushtetuese).*

12. Sistemi i garancive që gëzojnë gjyqtarët parashikohet edhe në dokumente ndërkombëtare. Kështu, Karta Evropiane për statusin e gjyqtarit, në paragrafin 1/1, shprehet se statusi i gjyqtarëve synon sigurimin e kompetencës, pavarësisë dhe paanësisë, elementë këto që çdo individ i pret në mënyrë legjitime nga gjykatat dhe nga çdo gjyqtar, të cilit i është besuar mbrojtja e të drejtave të individëve. Gjithashtu, “Parimet Bazë mbi Pavarësinë e Gjyqësorit” (miratuar me Rezolutat 40/32, datë 29 nëntor 1985 dhe 40/146, datë 13 dhjetor 1985 të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së), në paragrafin 11, sanksionojnë se mandati i gjyqtarëve, pavarësia e tyre, siguria, **paga e përshtatshme**, kushtet e shërbimit, pensionet dhe mosha e daljes në pension duhet të sigurohen nga ligji në mënyrë të përshtatshme (*shih vendimin nr. 31, datë 02.12.2009 të Gjykatës Kushtetuese).*

13. Në vendimin Nr. 40, datë 07.07.2014 Gjykata Kushtetuese ndër të tjera ka theksuar se: “19. Sipas jurisprudencës së Gjykatës, neni 138 i Kushtetutës përcakton elementë përbërës të statusit të gjyqtarit, pa të cilët nuk mund të garantohet ushtrimi i pavarur i funksionit të tyre. **Garancitë e kësaj norme të Kushtetutës u njohin gjyqtarëve një trajtim specifik jo vetëm në pagë, por edhe në elementë të tjerë që burojnë nga ushtrimi i funksionit të tyre. Paprekshmëria e pagës dhe e përfitimeve të tjera janë ngritur në nivel kushtetues, me qëllim që të drejtat/përfitimet, të cilat burojnë nga ushtrimi i funksionit të gjyqtarit, të mos ndryshohen me efekt negativ. Formulimi i togfjalëshit “përfitime të tjera” është i një natyre të përgjithshme dhe nuk konkretizon në mënyrë shteruese rrethin e përfitimeve të gjyqtarëve. Kushtetutbërësi, jo pa qëllim e ka lënë të hapur kuptimin që i duhet dhënë rrethit të përfitimeve, pasi ka synuar të përfshijë në të tërësinë e të drejtave që gjyqtarët i gëzojnë në funksion të ushtrimit të detyrës së tyre (shih vendimin nr. 31, datë 02.12.2009 të Gjykatës Kushtetuese)....**

23. Parimi i sigurisë juridike mbron garancitë që rrjedhin nga neni 138 i Kushtetutës, ku përfshihet edhe e drejta e karrierës, si pjesë përbërëse e statusit të gjyqtarit dhe një nga përfitimet e tjera që gjyqtarët gëzojnë, për shkak të funksionit. **Gjykata ka theksuar se siguria juridike është ndër elementet thelbësore të shtetit të së drejtës. Qëllimi i parimit të sigurisë juridike është të sigurojë besimin e personave të shteti e ligji dhe, vetë gjyqtarët, të cilët administrojnë drejtësinë duhet të gëzojnë një besim të tillë.** Ligjvënësi ka detyrimin të rregullojë, në mënyrë më të hollësishme, të drejtat dhe garancitë e parashikuara në Kushtetutë. Në kuadrin e këtij rregullimi ai mund të vendosë dhe kufizime, por këto kufizime duhet të bëhen vetëm për një interes publik, për të mbrojtur të drejtat e të tjerëve me mënyra dhe forma që të jenë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar ndryshimin dhe pa

prekur thelbin e të drejtës dhe garancisë (shih vendimet nr. 11, datë 06.03.2014; nr. 9, datë 26.02.2007; nr. 11, datë 04.04.2007; nr. 36, datë 15.10.2007; nr. 26, datë 02.11.2005; nr. 34, datë 20.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese).”.

14. Në vendimin Nr. 20, datë 01.06.2011 Gjykata Kushtetuese ndër të tjera thekson se: “**Ndikimi i padiskutueshëm i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është i tillë që iu imponon të gjithë organeve shtetërore, duke mos përjashtuar as gjykatat, fuqinë detyruese të arsytimit të vendimit të saj. Arsyetimi që përdor Gjykata Kushtetuese në vendimet e saj ka forcën e ligjit, çka buron nga autoriteti i këtij organi për të thënë fjalën e fundit në çështjet për të cilat të tjerët tashmë janë shprehur. Çdo qëndrim i kundërt krijon një precedent të rrezikshëm në marrëdhëniet institucionale (Shih vendimin nr. 5 datë 07.02.2001 të Gjykatës Kushtetuese). Nisur nga tagrat që i jep neni 124 i Kushtetutës, roli dhe funksioni i Gjykatës Kushtetuese është që nëpërmjet vendimeve të transformojë dispozitat kushtetuese nga abstrakte-metafizike, në substanciale dhe konkrete, duke i garantuar mbrojtje kushtetuese situatave juridike në të cilat ndodhen individët. Për shkak të vetë formës ekstremisht konçize që kanë dispozitat kushtetuese, nëpërmjet vendimeve, pra interpretimit që bën Gjykata, bëhet e mundur që Kushtetuta të jetë “e gjallë”, që do të thotë se Gjykata i përshtatet evolucionit që bëjnë vlerat në vendin tonë, duke garantuar që vlera të reja, të cilat ndoshta nuk ishin në vëmendje të hartuesve të Kushtetutës, të marrin dinjitet, njohje dhe, mbi të gjitha, mbrojtje kushtetuese. Për vetë faktin se norma kushtetuese bëhet realitet gjatë interpretimit, pra gjatë procesit vendimmarrës të Gjykatës, e bën këtë të fundit pa diskutim burim të së drejtës, për më tepër e bën atë një burim parësor të saj, duke pasur parasysh se neni 4 i Kushtetutës parashikon se Kushtetuta është ligji më i lartë në Republikën e Shqipërisë.**” Pra, sipas këtij vendimi, vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë të njëjtë fuqi me Kushtetutën që ka epërsi mbi aktet e tjera normative të parashikuara nga neni 116 i Kushtetutës.

15. Kushtetuta në nenin 138 të saj ka garantuar gjyqtarët lidhur me statusin e tyre, në pjesën e të drejtave që rrjedhin nga ushtrimi i detyrës, duke parashikuar se pagat dhe përfitimet e tjera nuk mundet të ulen. Në të njëjtën kohë ajo ka parashikuar edhe përjashtimet nga ky rregull si një rezervë kushtetuese. Përjashtimet nga ky rregull kushtetues janë: **a)** nevojitet marrja e masave të përgjithshme ekonomiko – financiare për të shmangur situata të vështira financiare të vendit ose emergjenca të tjera kombëtare; **b)** gjyqtari kthehet në detyrën që mbante para emërimit; **c)** i jepet një masë disiplinore ose vlerësohet i pamjaftueshëm profesionalisht, sipas ligjit. Në të njëjtën mënyrë ka rregulluar dhe detajuar edhe Ligji nr. 96/2016, duke përfshirë në këtë garanci edhe magjistratët prokurorë.

16. Në rastin konkret konstatohet se gjyqtarët, ndër të drejtat që gëzojnë për shkak të ushtrimit të detyrës dhe pjesë e statusit të tyre, është pagesa që ata marrin gjatë ushtrimit të detyrës si në ditën normale të punës ashtu dhe pagesa ditën e pushimit javor javor si dhe në ditën e festave zyrtare. Mendojmë se, udhëzimi Nr. 38, datë 28.02.2019 “PËR PAGESAT E GJYQTARËVE NË DITËT E PUSHIMIT JAVOR DHE FESTAVE ZYRTARE” i Këshillit të Lartë Gjyqësor, duhet të ndryshohet dhe plotësohet, për arsye si më poshtë vijon:

**16.1. Së pari**, sipas kuadrit ligjor para nxjerrjes së udhëzimit Nr. 38, datë 28.02.2019 gjyqtarët që ishin në listën e gadishmërisë merrnin kompensim të plotë për ditët e pushimit javor dhe festat zyrtare, pavarësisht nëse merrnin vendime në këto ditë. Ndodhur në këto

kushte, në respektim të nenit 138 të Kushtetutës dhe vendimit Nr. 40, datë 07.07.2014 të Gjykatës Kushtetuese paprekshmëria e pagës dhe e përfitimeve të tjera janë ngritur në nivel kushtetues, me qëllim që të drejtat/përfitimet, të cilat burojnë nga ushtrimi i funksionit të gjyqtarit, të mos ndryshohen me efekt negativ. Ky parim është sanksionuar edhe në nenin 22 të Ligjit Nr. 96/2016, ku parashikohet shprehimisht se: “1. **Paga dhe përfitimet e tjera të magjistratit nuk mund të ulen...**”.

**16.2. Së dyti**, në nenin 37 gërma “b” të Ligjit Nr. 98/2016 parashikohet se: “**Kryetari i gjykatës ka përgjegjësi për menaxhimin e përgjithshëm gjyqësor dhe ushtron këto detyra: ...b) në fillim të çdo viti miraton një listë, e cila përditësohet kur është e nevojshme, që përcakton gjyqtarët për gjykimet e rasteve urgjente, sic përcaktohet me ligj, sipas rendit alfabetik me bazë mbiemrin**, në përputhje me rregullat e miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor;..”, ndërsa në nenin 91 pika 4 të këtij Ligji i Ligji parashikohet se: “4. **Të gjitha aktet nënligjore, të miratuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, zbatohen për aq sa nuk bien në kundërshtim me këtë ligj.**”. Mendojmë se, vendimi Nr. 238/1/a Datë 24.12.2008 “PËR PROCEDURAT E NDARJES ME SHORT TË ÇËSHTJEVE GJYQËSORE” i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i ndryshuar, zbatohet në veprimtarinë e përditshme të gjykatave, pasi nuk ka humbur fuqin e tij ligjore. Kështu, në nenin 1 të këtij vendimi, nën titullin “**Ndarja e çështjeve me short**” parashikohet shprehimisht se: “1. **Shorti i çështjeve që paraqiten në gjykatat e shkallës së parë dhe në gjykatat e apelit, realizohet vetëm në rrugë elektronike. 2. Bëjnë përjashtim nga hedhja në short, këto raste: a -kërkesat penale gjatë hetimeve paraprake, për gjykimin e të cilave bëhet planifikimi i gjyqtarëve nga kryetari i gjykatës sipas ligjit nr.9877 datë 18.02.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, neni 18, pika 3, gërma “c” b - kërkesat civile të natyrës urgjente si: lëshim i urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, sigurim i padisë, apo çdo kërkesë tjetër me karakter të ngutshëm procedural, si edhe për kërkesat penale të parashikuara nga gërma “a” e kësaj dispozite, të paraqitura gjatë periudhës së lejes vjetore. Këto kërkesa, mund të mos i nënshtrohen procedurave të shortit të mësipërm, por i kalojnë për shqyrtim gjyqtarit të planifikuar për periudhën e gatishmërisë nga kryetari i gjykatës.**”. Nga përmbajtja këtyre akteve rezulton se gjyqtari që është planifikuar për periudhën e gatishmërisë nga kryetari i gjykatës është një gjyqtar që “është në detyrë” për ditën e pushimit javor dhe pushimet zyrtare, ndryshe nga pjesa tjetër e gjyqtarëve që nuk janë pjesë e kësaj liste. Për rrjedhojë gjyqtarët e gatishëm duhet të trajtohen njëllë me çdo gjyqtar që ushtron detyrën gjatë ditëve normale të punës pavarësisht nëse marrin vendime apo jo. Nga Këshilli i Lartë Gjyqësor duhet të shtrohet për zgjidhje situata juridike nëse një gjyqtar gjatë ditës normale të punës (e hënë - e premte) nuk ka planifikuar seanca gjyqësore e për rrjedhojë nuk merr vendime a duhet të paguhet? Nëse përgjigjia e kësaj pyetje do të ishte pozitive, atëherë nuk ka sens logjik e juridik që një gjyqtar që ditët e pushimit javor apo festave zyrtare është në punë të mos kompesohen financiarisht në mënyrë të plotë.

**16.3. Së treti**, Gjyqtari, gjatë ushtrimit të funksionit duhet të trajtojë dhe gjykojë çështjet që i caktohen brenda një afati të arsyeshëm të përshtatshëm, pa cenuar cilësinë e vendimit, duke u kujdesur që të përcaktojë afate të arsyeshme për palët dhe për veten e tij. Ai duhet të sigurojë administrim të drejtë të procesit gjyqësor dhe t’i kushtojë kujdes çdo pretendimi të bërë për shkelje të të drejtave. Veprimtaria profesionale e tij duhet t’i kushtohet ushtrimit të funksionit dhe administrimit të drejtësisë, duhet të mos cenojë kryerjen me

përkushtim të detyrave gjyqësore dhe në mënyrë të vazhdueshme duhet të synojë arritjen e nivele të larta të aftësive profesionale, duke ndërmarrë hapa të arsyeshëm për të ruajtur dhe rritur njohuritë, aftësitë dhe cilësitë personale, të nevojshme për kryerjen e detyrave gjyqësore.<sup>1</sup> **Pra, gjyqtari edhe gjatë ditëve të pushimit javor kur shqyrton kërkesa të ngutshme duhet të ketë në konsideratë të japë drejtësi dhe jo të jetë i detyruar që të marrë një vendim me shpejtësi duke cënuar cilësinë dhe drejtësinë. Shqyrtimi i çështjeve urgjente që njëkohësisht janë voluminoze mund të kërkoj një ditë studim me qëllim që ditën tjetër gjyqtari të jenë i gatshëm për të marrë një vendim të drejtë e të bazuar në ligj. Sipas udhëzimit në fuqi, në këtë situatë juridike gjyqtari edhe pse ka qëndruar një ditë duke u marrë vetëm me studimin e një dosje do të paguhet vetëm për ditën e dytë të pushimit javor që korrespondon me ditën e marrjes së vendimit. Mendojmë se në këtë situatë juridike nuk respektohet neni 11 i Ligjit Nr. 96/2016, ku parashikohet se: “1. Paga e magjistratit dhe përfutimet e tjera financiare duhet të jenë në përputhje me dinjitetin e detyrës së magjistratit dhe të përshtatshme për të garantuar pavarësinë.”**

**16.4. Së katërti**, në vendimin Nr. 17, datë 17.01.2022 “PËR ANULIMIN E VENDIMIT NR.464, DATË 01.12.2021, TË ZËVENDËSKRYETARIT TË GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR GJIROKASTËR” Këshilli i Lartë Gjyqësor, ndër të tjera arsyeton se: **“41. Në kryerjen e funksioneve gjyqësore gjyqtarët, ndryshe nga pjesa më e madhe e kategorive të tjera të funksionarëve publik, nuk i nënshtrohen, pikërisht për shkak të natyrës së veçantë të veprimtarisë së kryer, një paracaktimi të rreptë të orarit të punës, pasi ndër të tjera puna e gjyqtarit është dhe punë krijuese dhe hulumtuese. Funksioni gjyqësor ushtrohet në kushte pavarësie të gjyqtarit dhe për rrjedhojë, performanca e punës së tij, për më tepër, nuk mund të konsiderohet e përmbushur në kryerjen vetëm të veprimtarive të cilat janë të planifikuara në orë të paracaktuara, por përfshin edhe kryerjen e aktiviteteve profesionale, studimet, hulumtimet, arsyetimet e vendimeve gjyqësore dhe shumë veprimtari që lidhen dhe i shërbejnë detyrës, të cilat zhvillohen jashtë çdo orari të paracaktuar dhe normalisht mund të kryhen edhe jashtë zyrave gjyqësore. Një ndër detyrat e gjyqtarit është dhe hulumtimi dhe zbatimi i praktikave më të mira vendase dhe të huaja, në funksion të dhënies së drejtësisë dhe të një vendimi të mirëarsyetuar, e cila është baza që tregon dhënien e një vendimi të drejtë e të bazuar në prova e ligj. Vetë ligji, për të mbrojtur dhe garantuar pavarësinë e gjyqtarit në organizimin e punës, nuk ka përdorur termin “mungesa në punë”, siç e ka përdorur rregullisht kur i është referuar ditës së punës, por ka përdorur termin “mungesë në detyrë”, pra një mungesë në ushtrimin e funksionit dhe detyrave të gjyqtarit.”** Pra, në kuadrin e interpretimit evolues të bërë nga vetë Këshilli i Lartë Gjyqësor legjislacionit që garanton statusin e gjyqtarit pranohet me të drejtë se veprimtari e gjyqtarit nuk kufizohet edhe gjatë ditëve të gadishmërisë vetëm në marrjen e një vendimi gjyqësor, pasi edhe në këto ditë gjyqtari është në detyrë, duke kryer punë krijuese dhe hulumtuese, duke u marrë me aktivitete profesionale si studimet, hulumtimet, arsyetimet e vendimeve gjyqësore dhe shumë veprimtari që lidhen dhe i shërbejnë detyrës. **Mendojmë se ky vendim mund të mbahet në konsideratë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor edhe në saktësimin se gjyqtarët gjatë ditëve të pushimit javor dhe festave zyrtare duhet të**

---

<sup>1</sup> Kreu II, Seksioni D i Kodit të Etikës Gjyqësore nën titullin “Parimin e kujdesit të duhur dhe profesionalizmit”.

kompesionet plotësisht për ditën e punës dhe jo të paguhen me orë punë, pasi ndryshe nga pjesa më e madhe e kategorive të tjera të funksionarëve publik, nuk i nënshtrohen, pikërisht për shkak të natyrës së veçantë të veprimtarisë së kryer, një paracaktimi të rreptë të orarit të punës.

#### IV. Konkluzioni

17. Sa më sipër u arsyetua, SH.K.GJ.R.SH-ja kërkon ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Nr. 38, datë 28.02.2019 “PËR PAGESAT E GJYQTARËVE NË DITËT E PUSHIMIT JAVOR DHE FESTAVE ZYRTARE” i Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke sanksionuar se:

1. Gjyqtarët që janë në listën e gadishmërisë për të gjykuar gjatë pushimit javor apo ditëve të festave zyrtare duhet të kompesohen financiarisht pavarësisht nëse marrin vendime; dhe
2. Gjyqtarët të cilët nuk janë të gatshëm por dalin në punë dhe zhvillojnë seanca e japin vendime në ditët e pushimeve javore dhe festve zyrtare në kuadër të shqyrtimit të kërkesave të fazës së hetimeve paraprake sipas nenit 278/2 të K.Pr.Penale<sup>2</sup> duhet të kompesohen financiarisht në mënyrë të plotë sikurse parashikohet në shkresën Nr. 2491/1 Prot., datë 28.05.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe jo me orë pune pasi nuk është në përputhje me dinjitetin e detyrës së magjistratit.

*Me respekt dhe konsideratë të lartë për Ju!*

**KRYETARI I SHOQATËS**

**ERJON BANI**

---

<sup>2</sup> Në nenin 278 të K.Pr.Penale nën titullin “Kompetencat e gjykatës së shkallës së parë në hetimet paraprake” parashikohet shprehimisht se: “1. Gjatë hetimeve paraprake, për rastet e parashikuara nga ligji, mbi kërkesën e prokurorit, të pandehurit, të dëmtuarit dhe palëve private, vendos gjykata. 2. Kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake, sipas paragrafit 1, të këtij neni, shqyrtohen nga i njëjti gjyqtar”.